

V E N D I M
Nr.53, datë 27.6.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më dtë 30.5.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.35 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: GENTIAN HAMZAI, përfaqësuar nga avokat Viktor Konomi, me autorizim.

O B J E K T I

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.76, datë 2.3.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.361, datë 5.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Avokati i të gjykuarit në mungesë, pretendon se vendimi i Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe vendimi i Kolegjit Penal të gjykatës së Lartë, të cilët kanë vendosur moslegjitimimin të të gjykuarit në mungesë për të bërë ankim, pasi nuk ka qenë i pajisur me prokurë nga vetë i gjykuari, janë antikushtetues dhe kërkon shfuqizimin e tyre, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Në rastin konkret, ndodhemi përpara një procesi të parrregullt ligjor, pasi të pandehurit i është mohuar një nga të drejtat themelore kushtetuese, e drejta e mbrojtjes.

- Vendimet e sipërcituara bien ndesh me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka konsideruar si antikushtetues qendrimin e mbajtur nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për këtë problem.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, avokatin e të gjykuarit në mungesë dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Mbi ankimin e mbrojtësit të të gjykuarit në mungesë të caktuar kryesisht, Gjykata e Apelit të Tiranës me vendimin nr.76, datë 2.3.2000, ka vendosur mospranimin e ankimit, me arsyetimin se ai nuk legjitimohet të bëjë ankim, derisa nuk është pajisur me prokurë nga vetë i gjykuari.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke ju referuar vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë datë 29.7.1999, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës me të njëjtin arsyetim.

Pretendimi i kërkuarit, se gjykatat kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, sepse padrejtësisht i kanë mohuar mbrojtësit të të gjykuarit në mungesë të drejtën për të ushtruar ankim ndaj vendimeve gjyqësore, është i drejtë dhe kërkesa duhet pranuar.

E drejta e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor është një e drejtë kushtetuese dhe askush nuk mund të privohet nga realizimi i saj. E drejta e ankimit të të gjykuarit, si një garanci që i shërben realizimit të të drejtës së mbrojtjes nuk mund t'i mohohet avokatit të tij, pasi edhe në rastin e gjykimit në mungesë mbrojtësi gëzon të gjitha të drejtat, për sa kohë që vetë i gjykuari nuk ia ka hequr atij në

mënyrë të shprehur të drejtën e përfaqësimit.

Çështja e realizimit të të drejtës së ankimit nga mbrojtësi i të gjykuarit në mungesë, i caktuar nga familjarët e tij ose kryesisht nga gjykata, përbën tashmë dhe një qëndrim që po zbatohet në praktikën e gjykatave të zakonshme, si rrjedhojë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 17.4.2000 dhe nr.5, datë 7.2.2001. Në këto vendime të Gjykatës Kushtetuese është konfirmuar përfundimisht, në aspektin kushtetues dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, se e drejta e ankimit i përket edhe mbrojtësit të të gjykuarit në mungesë, pavarësisht nga forma e përfaqësimit, si një nga kushtet për realizimin e së drejtës së mbrojtjes.

Mbi bazën e argumenteve të parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se vendimet e gjykatës së apelit dhe të kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke mohuar të drejtën e mbrojtësit të të gjykuarit në mungesë për të bërë ankim ndaj vendimeve gjyqësore, kanë cenuar njëkohësisht edhe të drejtën e kërkuarit për një proces të rregullt ligjor, shkelje këto që bien ndesh me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.76, datë 2.3.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.361, datë 5.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes së Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.